



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



# **ANALIZA E DEMOKRACISË BRENDA-PARTIAKE NË MAQEDONI**

Qendra për hulumtim dhe  
ndërtim të politikave



**POLITIKE**

# **I M P R E S U M**

## **Titulli**

Analiza e demokracisë brenda-partiake në Maqedoni

## **Botues**

Konrad-Adenauer-Stiftung, Zyra në Shkup / Maqedoni

## **Autorë**

Aleksandar Cekov dhe Dr. Zhidas Daskalovski, Qendra për Hulumtim dhe ndërtim të politikave, Republika e Maqedonisë

## **Hulumtim dhe analizë**

Dr. Marija Risteska, Jeton Krasniqi, Lulëzim Selami dhe Marija Aleksoska

## **Përkthim nga anglisht**

Perica Sarxhoski

## **Përgatitje dhe shtypje**

Vinsent Grafika

## **Numri i kopjeve**

Botimi mund ta gjeni falas në:

[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)

[www.crpm.org.mk](http://www.crpm.org.mk)

## **Shënim**

**Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk i përfaqësojnë qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer, por janë pikëpamjet personale të autorëve.**

# **ANALIZA E DEMOKRACISË BRENDA-PARTIAKE NË MAQEDONI**

Qendra për hulumtim dhe  
ndërtim të politikave

**POLITIKE**

# **PËRMBAJTJA**

**3** | PARATHËNIE

**6** | 1. HYRJE

**7** | 1.1 DEBATI NË LIDHJE ME DEMOKRACINË BRENDA  
PARTIAKE

**10** | 1.2 METODOLOGJIA

**13** | 2. VLERËSIMI I DEMOKRACISË BRENDA PARTIAKE NË  
MAQEDONI

**32** | 3. MARRËDHËNIET NDËRMJET ORGANEVE  
QENDRORE TË PARTISË DHE DEGËVE LOKALE

**42** | 4. ZGJEDHJET DHE DEMOKRACIA BRENDA PARTISË

**46** | 5. KONKLUZION

**51** | REFERENCA

## PARATHËNIE

Konrad Adenauer Stiftung (KAS) në bashkëpunim dhe angazhimin e tij ndërkombëtar ka mbështetur gjithmonë në mënyrë aktive në mbarë botën promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë, vlerave dhe praktikave të saj, si dhe promovimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe parimeve të ekonomisë sociale të tregut.

Aktualisht Konrad-Adenauer-Stiftung ka rreth 70 zyra me 80 përfaqësues zyrtarë nga Gjermania dhe ka mbi 400 njerëz të punësuar vendas që ndihmojnë në zbatimin e masave për edukim dhe konsultim politik. Të gjitha këto masa synojnë të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit dhe konsolidimit të demokracisë.

Brenda programeve tona në pothuajse çdo vend, masat këshillëdhënëse për bashkëpunim dhe mbështetje për partitë moderne demokratike, janë pika qendrore e veprimit tonë ndërkombëtar, sepse në një demokraci, qytetarët duhet doemos të përfshihen në veprimin politik. Megjithatë, një demokraci e drejtpërdrejtë, ku çdo qytetarë është i përfshirë drejtpërdrejt në vendimmarrjen politike, nuk është e mundur brenda shoqërive moderne masive. Kjo është arsyeja pse

një demokraci moderne ka nevojë për parti politike mirë të strukturuar që përfaqësojnë vullnetin dhe interesat e qytetarëve në mënyrë sa më autentike që të jetë e mundur dhe ofrojnë hapësirë për angazhimin politik, në mënyrë që të ndikojnë në politikën dhe vendimet politike.

Ne jemi të bindur se pa parti politike moderne dhe demokratike, një demokraci moderne përfaqësuese nuk është e mundur dhe vetëm partitë që sigurojnë mekanizma për përfshirjen e qytetarëve janë garanci se dëgjohet zëri i gjerë i shoqërisë. Prandaj është me rëndësi që të hidhet një vështrim më i afërt, jo vetëm në programet politike të partive, por edhe në organizimin e tyre të brendshëm, mënyrën e zhvillimit të diskutimeve të brendshme, debatet dhe konfliktet brenda dhe midis degëve të ndryshme dhe grupeve të partisë dhe rekrutimin e kandidatëve dhe përfshirjen e anëtarëve. Këto janë karakteristikat thelbësore për një strukturë të partisë moderne dhe demokratike, veçanërisht, nëse partia synon të qeverisë një vend demokratik. Ajo do të jetë në gjendje të përmbush funksionet dhe detyrat e saj dhe të ruajë kredibilitetin, nëse dëshmon në organizimin e saj një angazhim të qartë për vendosjen e strukturave dhe rregullave demokratike dhe nëse vazhdon të punojë fuqimisht në atë drejtim.

Studim i kryer nga Thint Tank-u, Qendra për Hulumtim dhe Ndërtim të Politikave (CRPM) në bashkëpunim me autorë të tjerë maqedonas trajton temën "Demokracia Brenda – Partiake në Republikën e Maqedonisë". Ajo shqyrton, përshkruan dhe krahason demokracinë brenda partisë në disa prej partive më të mëdha politike në Republikën e Maqedonisë, në mënyrë që të sigurojë një bazë për zhvillimin dhe konsolidimin e strukturave demokratike dhe mundësitë e pjesëmarrjes për anëtarët e tyre.

Për lexim të mëtejshëm mbi organizimin dhe funksionimin e partive politike në përgjithësi, do të dëshironim të rekomandojmë edhe librin "Partitë Politike", shkruar nga kolegët nga KAS-i, Vilhem Hofmeister dhe Karsten Grabou. Libri është botuar nga KAS dhe mund të shkarkohet nga interneti ([www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)) ose të merret nga zyra e KAS-it në Shkup.

Anja Çimek  
Konrad Adenauer Stiftung  
Republika e Maqedonisë

# 1

## HYRJE ANALIZA E DEMOKRACISË BRENDA PARTIAKE NË MAQEDONI <sup>1</sup>

Demokracia e brenda partiake në demokracitë në zhvillim ka qenë gjithmonë një çështje sfiduese. Për më tepër, demokracia në partitë në këto vende është analizuar dhe vlerësuar kryesisht nga aspekti i kontributit të saj në zhvillimin e proceseve demokratike të përgjithshme (Cular, 2010). Përkundër rritjes së popullaritetit të këtij termi në debatin akademik, duket se nuk ekziston përcaktim universal që tërësisht shpjegon konceptin, madje as një recetë se si të menaxhohet në praktikë zbatimi i parimeve demokratike. Pavarësisht nga të metat konceptuale dhe teorike, ithtarët e demokracisë së brendshme argumentojnë se nxitja e parimeve demokratike brenda partisë mund të kontribuojë edhe në zhvillimin e proceseve të përgjithshme demokratike në demokracitë në zhvillim (Scarow 2005; Lehrer, 2012; Burnell dhe Gerits 2010). Në Maqedoni, ngjashëm si në vendet e tjera post-komuniste të Evropës Juglindore, trashëgimia e kulturës partiake nga e kaluara siç është tendenca e fortë hierarkike, zgjedhje të udhëheqësisë pa konkurrencë dhe

---

<sup>1</sup> Autorë të raportit janë Aleksandar Cekov dhe Zhidas Daskalovski. Ndhimë hulumtuese nga Jeton Krasniqi, Marija Aleksoska, Iskra Gerazova.



qasja nga lartë poshtë në procesin e vendimmarrjes janë ende pjesë e organizimit të partisë (Karasimeonov, 2005). Karakteristikat e tilla të organizimit brenda partiak në Maqedoni mund të pengojnë në masë të madhe zhvillimin e proceseve demokratike brenda partive, si dhe në vend. Prandaj, ekziston një nevojë për të bërë një vlerësim të demokracisë brenda partisë në Maqedoni me qëllim që të identifikohen sfidat kryesore me të cilat përballet ky proce, dhe që të ofrohen argumente të besueshme për zhvillimin e mëtejshëm të procesit.

Analiza fillon me një përmbledhje të shkurtër të debatit akademik lidhur me demokracinë brenda partiake në mënyrë që të identifikojë karakteristikat kryesore të konceptit duke paraqitur fillesat kryesore teorike të demokracisë që kanë të bëjnë me këtë çështje. Pas shpjegimit të metodologjisë, punimi do të bëjë vlerësimin e demokracisë brenda partiak në Maqedoni duke u fokusuar në tri kategori të përgjithshme: niveli i përgjithshëm i demokracisë, marrëdhëniet ndërmjet organeve qendrore dhe degëve lokale dhe demokracia në parti dhe zgjedhjet. Në përfundim, punimi paraqet situatën e përgjithshme në Maqedoni lidhur me demokracinë brenda partiake, duke u bazuar në rezultatet e analizës.

### **1.1. DEBATI NË LIDHJE ME DEMOKRACINË BRENDIAKE**

Demokracia e brendshme ose demokracia brenda partiake është një term i gjerë që përfshin parimet demokratike në organizimin e partisë dhe një gamë të gjerë të metodave për përfshirjen efektive të përbërësve të partisë në vendimmarrje dhe në procesin e krijimit të politikave (Daskalovski et al., 2012). Kështu, organizimi partiak i bazuar në qasjen nga poshtë-lart, ruajtja e transparencës dhe përfshirja në procesin

e vendim-marrjes, si dhe përgjegjshmëria e lidershit të partisë janë parimet themelore që konsiderohen në përgjithësi si standarde të demokracisë së brendshme të partisë. Për më tepër, krijimi i vullnetit politik duhet të kryhet nëpërmjet një procesi të debatit të gjerë në mesin e qytetarëve, të cilët janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në strukturat e partisë në bazë të dimensionit gjinor, gjeografik dhe social. Në mënyrë që të analizohet ndikimi që demokracia brenda-partiake ka në funksionimin e partive politike dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e procesit të përgjithshëm demokratik në një vend, duhet të përkufizojmë dy çështje paralele që koncepti i ngërthen në vetvete: realizueshmëria e demokracisë brenda-partiake dhe dëshirueshmëria e tij. E para ka të bëjë me ndikimin që ky koncept ka në funksionimin e partive politike në drejtim të aftësisë së tyre për të konkurruar në mënyrë efektive në sistemin politik.

Gjegjësisht, pasi partitë politike tradicionalisht përcaktohen si institucione të centralizuara me tendencë të forta hierarkike (Mitchell, 1962), kjo u mundëson që ato të forcojnë kohezionin e partisë dhe të fitojnë në konkurrencën ndaj partive të tjera (Durverger, 1954). Nga ana tjetër, dijetarët që mbrojnë demokracinë brenda-partiake argumentojnë se partitë politike të organizuara mbi bazën e parimeve demokratike siç janë zgjedhjet brenda partiake konkurruese dhe jo-diskriminuese, proces i vendimmarrjes përfshirës dhe pjesëmarrëse janë mirë të pajisura për luftë ndër partiake në sistemin politik (Teorell, 1998; Biezen, 2004; Scarrow 2005). Ky pohim bazohet në argumentet se partitë politike që ushtrojnë demokraci të brendshme do të gëzojnë sukses më të madh elektoral, duke pasur parasysh se ata zgjedhin kandidatët më të aftë dhe kanë politika më të përgjegjshme që përputhen me nevojat e qytetarëve (Scarrow, 2005).

Avantazhi i demokracisë brenda partiake për zhvillimin e procesit të përgjithshëm demokratik në një shoqëri është një çështje për të cilën dijetarët ende nuk e kanë gjetur një gjuhë të përbashkët. Çështja e avantazhit të demokracisë brenda-partiake, në masë të madhe, varet nga qasja teorike e përvetësuar.

Kështu, teoria liberal demokrate nuk i kushton vëmendje të veçantë demokracisë brenda partisë. Sipas Sartori-t (2005), roli i lidhshëm të partive politike është shumë më i rëndësishëm se pjesëmarrja e qytetarëve, roli i të cilëve është që thjesht të pranojnë ose refuzojnë udhëheqësit e tyre dhe platformat politike gjatë zgjedhjeve. Kjo është në përputhje me parimin e teorisë liberal demokrate që kupton demokracinë jo si një qëllim në vetvete, por në drejtim të funksionit të saj për të mbrojtur parimet demokratike më mirë se sistemet e tjera politike (Katz, 1997: 46).

Në anën tjetër, ithtarët e demokracisë pjesëmarrëse dhe vendimmarrëse i kushtojnë vlerë më të madhe demokracisë brenda-partiake dhe tipareve kryesore saj: pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes dhe zgjedhjet konkurruese dhe jo-diskriminuese brenda partisë. Për teorinë e demokracisë pjesëmarrëse dhe vendimmarrëse, sistem i plotë demokratik mund të quhet ai në të cilin agjentët kryesorë të demokracisë (partitë politike) në vetvete përkrahin parimet demokratike (Biezen, 2004). Për më tepër, duke pasur parasysh se demokracia është parë si një produkt i vendimmarrjes në mesin e qytetarëve të lirë, të barabartë dhe racional (Elser, 1998), partitë politike duhet të sigurojnë një forum ku qytetari mundet lirisht të shprehë preferencat dhe nevojat e tij që ato në mënyrë efektive të përfaqësohen nga udhëheqësit politikë. Duke u mbështetur në debatin mbi demokracinë ndër-partiake, mund të konstatohet se të dy

fillesat teorike kanë dhënë argumente bindëse. Demokracia e tepërt brenda partisë mundet vërtetë të dëmtojë kohezionin e partisë dhe të pakësojë konkurrencën partiake kundër partive të tjera pasi dobëson udhëheqësin e partisë, gjë që përfundimisht mund të ndikojë negativisht në aftësinë e palës për të mbajtur premtimet elektorale. Për më tepër, duke pasur fraksione që luftojnë mes vete, kjo dëmton stabilitetin brenda partisë që mund të reflektohet në sistemin politik. Megjithatë, partitë politike duhet të mbështesin të paktën parimet themelore demokratike brenda partisë që mund të rezultojë e dobishme për proceset e përgjithshme demokratike në një vend sepse mund të nxisin praktikën, kulturën dhe ideologjin demokratike në shoqëri. Prandaj, në varësi të kontekstit shoqëror dhe politik në të cilin veprojnë, partitë politike duhet të përpiqen që të arrijnë ekuilibrin e duhur në mes demokracisë partiake, në drejtim të përgjegjësisë shoqërore që ata kanë për zhvillimin e proceseve të përgjithshme demokratike dhe të ruajnë rolin e tyre si konkurrentë efektiv në sistemin politik duke përmbledhur preferencat e qytetarëve në anën tjetër.

## **1.2. METODOLOGJIA**

Analiza aplikon metodologji cilësor të hulumtimit. Grumbullimi i të dhënave përfshin analizë teksti nga burime primare (statutet e partive dhe dokumentet e tjera përkatëse të partive) dhe analizë të burimeve dytësore siç janë studime përkatëse mbi demokracinë brenda-partiake për Maqedoninë dhe rajonin, artikuj revistash dhe gazetash ditore. Për më tepër, analiza ligjore është kryer në kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e partive politike i cili përfshin Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike.

Punimi shqyrton dinamikën brenda gjashtë partive politike në Maqedoni: Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë (LSDM), VMRO-DPMNE, Partia Liberal-Demokrate, (PLD), Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), Partia Demokratike Shqiptare ( PDSH) dhe Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK).

Në mungesë të përcaktimit universal të demokracisë brenda partiake, analiza u përqendrua në elementet thelbësore instrumentale të demokracisë brenda partiake në Maqedoni. Pas qasjes që bën dallimin mes tri aspekteve të partisë, ai shqyrton: partinë në terren, partinë në zyrën qendrore dhe partinë në funksion publik (Katz dhe Mair, 2002).

Duke përdorur metodologjinë e zhvilluar nga stafi i CRPM,<sup>2</sup> analiza fokusohet në këto elemente instrumentale: anëtarësia partiake, organizim lokal, organizatat ndihmëse, numri i niveleve organizative, numri dhe lloji i organeve të partisë, procedurat e përzgjedhjes, si dhe marrëdhëniet me grupin parlamentar. Bazuar në metodologjitë ekzistuese, shkalla e demokracisë brenda partiake në Maqedoni do të vlerësohet duke përdorur këto shtatë dimensione: 1) Të drejtat e anëtarëve (përfshirë këtu tolerimin e fraksioneve partiake, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të anëtarëve në vendim-marrje dhe zgjedhje, në procedurat e përzgjedhjes, etj.), 2) marrëdhëniet ndërmjet partisë dhe grupit parlamentar të saj (përfshirë këtu pronësinë e mandateve parlamentare, votimin në kundërshtim me qëndrimin e partisë etj), 3) prerogativat e kryetarit të partisë (duke përfshirë të drejtën për të propozuar / emëruar nënkryetar, të drejtë të propozojë / emërojë anëtarë të tjetër të organeve qendrore etj); 4) struktura horizontale e partisë; 5) Autonomia e zyrave partiake lokale

---

<sup>2</sup> E njëjta metodologji u përdorë gjatë përgatitjes së punimit me titull "Analiza e demokracisë brenda partiake në Kosovë" nga CRPM.

(duke përfshirë edhe autonominë në vendimmarrje në lidhje me zgjedhjen dhe zëvendësimin e udhëheqësisë lokale, vendim-marrjen lokale, nëse zyrtarët e partisë nga nivele më të larta ex officio janë anëtarët të organeve lokale, 6) autonomia e degëve lokale në kohë të zgjedhjeve (që ka të bëjë me procedurën e përzgjedhjes për zgjedhjet lokale dhe koalicionet lokale); 7) kompetencat dhe procedura e zgjedhjes së liderëve të partive, (duke përfshirë prerogativat e konventave ndaj organeve ekzekutive); 8) propozimet e kandidatëve për funksionet publike dhe listat zgjedhore, (në sistemet proporcionale renditja e kandidatëve). Të gjitha dimensionet e përmendura do të vlerësohen me nota 1-3.<sup>3</sup> Këto dimensione janë grupuar në tri kategori: niveli i përgjithshëm i demokracisë, (kategoritë 1-4) autonomia e degëve lokale / marrëdhëniet e degëve qendrore dhe lokale (kategoritë 5 dhe 6) dhe demokracia dhe zgjedhjet (kategoritë 7 dhe 8).

---

<sup>3</sup> Dushan Pavloviq, Partitë politike dhe sistemi partiak në Serbi pas vitit 2000, në: Социолошки преглед, vol. XLI (jan.-mar. 2007), nr. 1, fq. 123-141. (si në Daskalovski et al., 2012)

# 2.

## VLERËSIMI I DEMOKRACISË BRENDA PARTIAKE NË MAQEDONI

Demokracia brenda partiake është një shprehje në modë në Maqedoni. Në debatin publik ka qenë i pranishëm që nga futja e sistemit shumëpartiak në fillim të viteve nëntëdhjetë. Ndërsa studiues dhe analistë kritikojnë haptazi nivelin e ulët të demokracisë brenda partiake në Maqedoni, liderët e partive dhe funksionarët vetëm në mënyrë deklarative pranojnë nevojën për më shumë demokraci brenda partive. Kështu, sipas analistit politik Mersel Billali „është një iluzion të mendojmë se ne mund të kemi shoqëri të shëndoshë pa parti politike të shëndosha, është e pamundur të ketë demokraci në shoqëri pa demokraci në partitë“. Në praktikë megjithatë, shumë pak është bërë për forcimin e proceseve demokratike brenda partive.<sup>4</sup> Gjendja e përgjithshme në Maqedoni lidhur me demokracinë brenda partiake ka qenë ndoshta më së miri e shpjeguar nga Gordana Siljanoska-Davkova që thotë se: „tragji-komik janë liderët e partive që flasin për demokracinë dhe zhvillimin e proceseve demokratike në vend, nga njëra anë, dhe drejtojnë si sulltanë partitë e tyre në anën tjetër“. Deklarata ngërthen disa nga tiparet thelbësore të organizimit

---

<sup>4</sup> „(Jo) demokracia partiake“, kolonë nga Mersel Bilali botuar ne të përditshmen “Dnevnik” më 18.03.2006

partiak në Maqedoni: mungesën e demokracisë dhe transparencës brenda partive dhe tendencat autokratike të liderëve partiak (Karasimeonov, 2005). Për më tepër, mund të thuhet se procesi i zhvillimit të demokracisë brenda partisë në Maqedoni përballet me sfida të ngjashme si demokracitë në zhvillim nga Evropa Juglindore: zgjedhja e kryetarit pa kundërkandidat, emërimi diskriminues i kandidatëve dhe dominimi i elitave (Daskalovski et al. , 2012). Organizimi i tillë i brendshëm i partive politike çon drejt fortifikimit të pozicionit të liderit të partisë dhe aftësisë së zvogluar të partisë që në mënyrë efektive të përfaqësojë preferencat e qytetarëve.

Në demokracitë moderne partitë politike u përgjigjen nevojave të qytetarëve duke përshtatur politikat e tyre me opinionin publik. Megjithatë, preferencat e qytetarëve dhe ato të anëtarëve të partisë mund shpeshherë të dallojnë shumë, duke vënë udhëheqjen e partisë në një pozicion të zgjedh nëse ajo do të jetë më e përgjegjshme ndaj anëtarëve të partisë apo elektoratit të përgjithshëm (Leher, 2012). Për më tepër, pasi udhëheqësia e partisë kërkon të ruajë pushtetin e saj brenda partisë, gjatë zgjedhjeve të organeve partiake ajo tenton të adresojë preferencat e „selektoratit“, të cilin Bruno de Mesquita (2002) e përcakton si „grup i njerëzve që kanë votën institucionale në zgjedhjen e udhëheqësve „. Kjo krijon një tjetër linjë të ndarjes mes selektoratit dhe anëtarëve „të rregullt“ të partisë me më pak ndikim në parti. Struktura e brendshme e tillë nënkupton që dinamika brenda partisë karakterizohet nga lufta në mes grupeve të ndryshme të cilat kërkojnë të ushtrojnë ndikim sa më të madh brenda partisë.

Në mënyrë që të kuptojmë më mirë dinamikat brenda partisë në Maqedoni në lidhje me përgjegjshmërinë e liderit të partisë për nevojat dhe preferencat e qytetarëve, selektoratit dhe anëtarëve të partisë, ekzaminohen organet bazë të



brendshme të partisë, duke përfshirë edhe rregullat formale dhe joformale mbi të cilat vepron partia.

- Mundësia ligjore për fraksione partiake (grupe që formojnë një grup të veçantë të interesit) bazuar në një çështje apo më shumë.

Mundësia e formimit të fraksioneve brenda partisë aktualisht qeverisëse në Maqedoni, VMRO-DPMNE nuk është përcaktuar qartë në statutin e partisë. Në praktikë, megjithatë, ka dëshmi se tendencat për krijimin e fraksioneve brenda partisë nuk tolerohen. Për shembull, Marjan Gjorçev dhe Dosta Dimovska së bashku me mbështetësit e tyre nuk u lejuan të veprojnë si fraksion legal në VMRO-DPMNE kur ata shprehën pakënaqësinë e tyre nga politika partiake nën udhëheqjen e Nikolla Gruevskit. Për më tepër, dallimet e forta në qëndrimet mes grupeve apo individëve që kanë deklaruar interesat e tyre specifike brenda partisë në njërën anë dhe shumica e anëtarëve të partisë në anën tjetër, kanë rezultuar pothuajse gjithmonë me marginalizimin apo edhe përjashtimin e grupit apo individëve të tillë. Shpesh, konfliktet mes funksionarëve të partisë dhe shumicës rezultojnë me krijimin e një partie të re nga të parët.

Duhet të theksohet megjithatë, se arsyeja për formimin e partisë së re janë më tepër mosmarrëveshjet personale mbi çështjet strategjike dhe operacionale sesa dallimet ideologjike. Kështu ishte rasti me Lube Boshkovskin (i cili vendosi të formonte Partinë e Bashkuar për Maqedoninë), Marjan Gjorçevin (Partia Bujqësore e Maqedonisë), Filip Petrovskin (Partia Demokratike e Djathtë), Dosta Dimovskën (Bashkimi Demokratik Republikan i Maqedonisë), Boris Zmejkovskin (VMRO- E vërtetë), dhe këto janë vetëm disa shembuj. Megjithatë, pas ekzistencës së shkurtër në skenën politike ku promovonin (ngjashëm me VMRO-DPMNE-në)

vlera demokratike-krishtere, të gjithë liderët e partive të lartpërmendura (përveç Ljube Boshkovski) në një moment të caktuar u ribashkuan me VMRO-DPMNE. Sipas drejtuesve të këtyre partive, një hap i tillë ishte pragmatik dhe i nevojshëm për të fituar zgjedhjet e ardhshme.<sup>5</sup> Duke arsyetuar vendimin e saj për t'iu ribashkuar VMRO-DPMNE-së, Dosta Dimovska ka deklaruar se: „Në frymën e dashurisë krishtere, duhet të pajtohemi dhe të harrojmë çdo mosmarrëveshjet personale mes nesh“. Mund të shtrohet pyetja nëse këto parti do të ishin formuar sikur fraksionet partiake të ishin legalizuar në mënyrë normative.

As Lidhja Social Demokrate të Maqedonisë<sup>6</sup> (LSDM) nuk lejo fraksionet, madje as nuk ka tendenca se do të tolerohej një veprim i tillë. Në vitin 2006, ish-udhëheqësi i partisë të LSDM-së Vllado Buçkovski<sup>7</sup> ngrihti një nismë për legalizimin normativ të fraksioneve partiake në LSDM nëpërmjet ndryshimeve statusore, si pjesë e një procesi më të gjerë të reformave në parti.<sup>8</sup> Megjithatë, një mundësi e tillë është hedhur poshtë kategorikisht nga udhëheqësia e partisë. Jani Makraduli, nënkryetar i partisë në atë kohë, mbrojti qëndrimin e partisë kundër fraksioneve duke deklaruar se: „Ne kemi analizuar shumë statute të partive me ideologji social-demokrate, por nuk kemi gjetur ndonjë shembull ku janë legalizuar fraksionet partiake“. Përveç kësaj, Karolina Ristova Asterud, funksionare dhe Sekretar Ndërkombëtare e LSDM-së, në kolonën e saj për të përditshmen Utrinski Vesnik ka argumentuar se përvojat krahasuese dhe shkenca politike nuk japin baza për krijimin e fraksioneve partiake.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> „Gruevski po bashkohet më Zmejkovskin, Gjorçevin dhe Dimovskën“ artikull i botuar në të përditshmen „Dnevnik“ më 18.03.2006

<sup>6</sup> Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë

<sup>7</sup> Kryetar i LSDM-së prej 2004 deri 2006

<sup>8</sup> Intervistë me Vllado Buçkovski e botuar në të përditshmen Utrinski Vesnik më 08.09.2012

<sup>9</sup> „Debat salloni mbi demokracinë në LSDM (2)“ kolonë nga Karolina Ristova Asterud botuar në të përditshmen Utrinski Vesnik më 09.02.2007

Mundësia për të pasur fraksione partiake nuk është përmendur në mënyrë eksplicite as në Statutet e Partisë Liberal Demokrat (PLD) dhe as në atë të Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Në BDI, dallime të mëdha në qëndrime mbi çështjet strategjike dhe operacionale me një tendencë të organizimit të fraksioneve janë vërejtur në vitin 2005, kur anëtarët e partisë ishin të ndarë në lidhje me çështjen e „regjionalizimit“ (grup i propozimeve dhe amendamenteve lidhur me Ligjin për organizimin territorial) e Maqedonisë.<sup>10</sup> Dallimet u bënë të dukshme me afrimin e zgjedhjeve lokale, kur secili grup përpiquej të fitojë pozita sa më të mira para zgjedhjeve. Ermira Mehmeti, Zëdhënësja e BDI-së në atë kohë, mohoi se këto „keqkuptime“ janë shenjë e ndarjeve brenda partisë me një tendencë të kalojë në fraksione partiake.<sup>11</sup> Duhet të theksohet se më herët Hisni Shaqiri, kreu i një nga grupet joformal në BDI, ka lënë partinë duke e akuzuar liderin e partisë Ali Ahmeti për manipulime të caktuara.

Sa i përket PLD-së, sipas funksionarit të partisë Nano Ruzhin, fraksionet e partisë në LDP lejohen në praktikë.<sup>12</sup> Ruzhini, i cili ishte ndër të tjerash kandidat për president të Republikës së Maqedonisë në zgjedhjet e fundit presidenciale, paralajmëroi një mundësi të tillë në dritën e zhvillimeve të fundit brenda partisë, kur Ivica Bocevski shprehu qëndrimin e tij të ndryshëm nga pozita zyrtare partiake për çështjet strategjike dhe operative në lidhje me zgjedhjet e ardhshme lokale në vitin 2013.<sup>13</sup> Duke komentuar mbi këtë çështje, Nano Ruzhin në një intervistë për të përditshmen Utrinski Vesnik tha se në një farë mase ky është një rast „revolucionar“ në kontekstin

---

<sup>10</sup> „BDI me tre rryma“ artikull i botuar në të përditshmen Vreme më 12.02.2005

<sup>11</sup> Ibid

<sup>12</sup> Intervistë me Nano Ruzhin botuar në të përditshmen Utrinski Vesnik, 24.10.2012

<sup>13</sup> Burim: gazeta e përditshme Utrinski Vesnik, botuar më 24.10.2012

e demokracisë brenda partisë i cili konfirmon gatishmërinë e PLD-së për të toleruar fraksione partiake.<sup>14</sup>

Statuti i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH) nuk përmend në mënyrë eksplicite mundësinë e formimit të fraksione partiake. Teorikisht, fraksionet e partisë mund të formohet në bazë të nenit 11.3 / 4 të Statutit që thotë: „Çdo anëtar partie ka të drejtë të shpreh lirisht mendimin e tij brenda partisë”.

Neni 11.3 / 4 gjithashtu mund të thirret në rastet kur opinioni i tillë nuk përputhet me shumicën në parti. Përveç kësaj, në zbatim të nenit 16, anëtarët e partisë nuk mund të mbahen përgjegjës për pikëpamjet e shprehura. Në praktikë, megjithatë, nuk ka indikacione se fraksionet partiake tolerohen brenda partisë. Për shembull, pas konfrontimit të Imer Selmanit me udhëheqjen e partisë në vitin 2008, ai braktisi partinë dhe inicio formimin e një subjekti të ri politik. Arsyet për këtë, sipas Selmanit, ishin mungesa e tolerancës për fraksionet partiake dhe niveli i përgjithshëm i ulët i demokracisë brenda partisë në të cilën ai kishte qenë anëtar i saj që në fillim të vitit 1996.<sup>15</sup>

Statuti i RDK-së nuk përmend mundësinë e të pasurit fraksione partiake. Asnjë tendencë e tillë nuk u shfaq në jetën politike gjatë periudhës relativisht të shkurtër, në të cilën partia ka ekzistuar. Mundësia për të kritikuar publikisht pozicionin e partisë.

Anëtarët e VMRO-DPMNE-së mund të shprehin mendimet e tyre individuale që janë në kundërshtim me pozicionet partiake zyrtare, dhe kjo zakonisht bëhet përmes kolonave në gazetë. Megjithatë, liria e shprehjes së mendimit individual është e kufizuar me nenin 16 të statutit i cili thotë se veprimet

---

<sup>14</sup> Intervistë me Nano Ruzhin botuar në gazetën e përditshme Utrinski Vesnik, 24.10.2012

<sup>15</sup> Intervistë me Imer Selmanin botuar në të përditshmen Dnevnik, 04.09.2008

kundër statutit, dokumenteve programore dhe akteve të tjera të partisë mund të sanksionohen madje edhe me përjashtim të anëtarit nga partia. Një interpretim i gjerë i këtij neni mund të kufizojë seriozisht lirinë e shprehjes individuale të anëtarëve të partisë. Në praktikë, nuk ekziston asnjë dëshmi e fortë për të shqyrtuar se si trajtohet kritika publike nga udhëheqësia e partisë.

Në LSDM, anëtarët kanë të drejtë të kenë opinione, propozime dhe qëndrime të ndara, të drejtën për të informuar dhe për të kërkuar mbështetje nga anëtarësia e tyre për një rishqyrtim të një çështjeje për të cilën ata nuk kanë marrë mbështetje të gjerë. Megjithatë, në realitet kjo mund t'i vendos ata në pozitë pakice gjatë debateve dhe vendimmarrjes madje edhe t'i marginalizojë. Për shembull, një marginalizim i tillë i ndodhi funksionarit të partisë Tito Petkovskit, pasi ai deklaroi publikisht qëndrimin e tij që ndryshonte nga qëndrimi i partisë në lidhje me ligjin për njohjen e Universitetit shqiptar në Reçicën e Vogël dhe Ligjin për riorganizimin territorial në vitin 2004.<sup>16</sup> Pas veprimit të shkurtër si pjesë e një fraksioni joformal në LSDM, Tito Petkovski la partinë në të cilën ai kishte qenë anëtar mbi 15 vjet dhe vendosi të formonte Partinë e Re Social Demokratike. Arsyeja për këtë, sipas Petkovskit, ishte „mungesa e demokracisë në LSDM, që haset edhe te partitë tjera në Maqedoni“.<sup>17</sup>

Shprehja e opinionit të ndryshëm ose të kundërt me qëndrimin zyrtar të partisë apo të shumicës së anëtarëve të saj në PLD lejohet në bazë të nenit 13 të Statutit. Megjithatë neni i njëjtë, nxit që mendimi i tillë të shprehet përmes organeve të partisë. Kështu ishte rasti me Ivica Bocevskin, zyrtar i partisë,

---

<sup>16</sup> "U vyshk trëndafilu në etiketën e Petkovskit" artikull i botuar në të përditshmen Utrinski Vesnik më 16.10.2006

<sup>17</sup> "Petkovski për herë të dytë brenda dy javëve në Shtip" artikull i botuar në të përditshmen Večer më 05.09.2006

i cili haptazi deklaroi pozicionin që ishte në kundërshtim me vendimin e partisë për të formuar koalicion me LSDM-në dhe partitë e tjera për zgjedhjet e ardhshme lokale në vitin 2013.<sup>18</sup>

Mundësia për të kritikuar publikisht qëndrimin zyrtar të partisë, ose mendimin e ndryshëm dhe të kundërt nga shumica në BDI në masë të madhe kufizohet nga neni 11 i Statutit, i cili parashikon sanksione për veprimet kundër statutit dhe programit të partisë siç është dëbimi nga partia. Në realitet, disiplinën dhe kohezionin në parti e ruan Ali Ahmeti, lideri partiaki i cili gëzon autoritet të pakontestueshëm në parti.<sup>19</sup>

Në PDSH, neni 11 i Statutit të partisë u jep mundësinë anëtarëve të shprehin lirisht mendimet e tyre të ndryshme dhe të kundërta nga shumica e partisë pa u mbajtur përgjegjës për veprimet e tilla. Megjithatë, kjo ndodh rrallë në praktikë, pasi kështu anëtarët e partisë rrezikojnë minorizimin dhe marginalizimin në procesin e vendimmarrjes.

Sipas statutit të RDK-së, anëtarët e partisë kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre brenda organeve partiake (neni 25). Për më tepër, neni 25.5 / 7 u jep anëtarëve të partisë të drejtën e iniciativës. Veprimet e anëtarëve të partisë, megjithatë kufizohen me nenin 26, i cili thotë se anëtarët e partisë janë të detyruar të respektojnë dispozitat statusore.

- A mundet deputeti të votojë në kundërshtim me qëndrimin e partisë në Parlament?

Grupi parlamentar i LSDM vepron në koordinim me vendimin e Këshillit Qendror (neni 76 i Statutit) dhe të paktën dy herë

---

<sup>18</sup> "Bocevski nuk e sheh veten në "të ardhmen" e Cërvenkovskit" botuar në të përditshmen Dnevnik më 24.10.2012.

<sup>19</sup> Intervistë me funksionar të BDI-së botuar në time.mk, 17.12.2009

në vit grupi parlamentar dorëzon një raport për punën e tij dhe bashkërendon punën e tij me Këshillin Qendror. Këshilli Qendror vlerëson punën e grupit parlamentar dhe jep sugjerime në lidhje me çështjet që debatohen në debat parlamentar (neni 77). Një renditje e tillë institucionale deputetëve iu lë hapësirë të kufizuar për manovra. Në praktikë, Tito Petkovski, si deputet i LSDM-së ka abstenuar nga votimi i besimit për qeverinë e LSDM-së, gjë që fuqimisht u shfaq edhe në publik, duke theksuar kështu, konfliktin e tij me udhëheqësinë e partisë.<sup>20</sup>

Teorikisht, anëtarët e grupit parlamentar të VMRO-DPMNE-së kanë mundësinë të votojnë ndryshe nga pozita zyrtare e partisë për një pyetje të veçantë, por këtë të drejtë nuk e ushtrojnë shpesh në praktikë. E njëjta gjë vlen edhe për deputetët e PLD-së. Në të dy rastet, pak a shumë, anëtarët i nënshtrohen disiplinës partiake që lë pak hapësirë për veprim individual.

Statuti i PDSH-së përcakton se grupi parlamentar i harmonizon aktivitetet e anëtarëve të saj dhe siguron që këto aktivitete të jenë në përputhje me statutin dhe programin e partisë (neni 54.3). Statuti i BDI-së në mënyrë të ngjashme rregullon aktivitetet e grupit të saj parlamentar në bazë të nenit 61.

- Procedurat zgjedhore për pozitat partiake: zgjedhjet e kryetarit të partisë/kush mund të votojë ligjërisht për kryetarë të partisë

Anëtarët e partisë të LSDM-së kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre dhe ai të merret parasysht. Kjo sepse të gjithë anëtarët duhet të përfshihen në zgjedhjen e udhëheqjes dhe

---

<sup>20</sup> "U vyshk trëndafilni në etiketën e Petkovskit" artikull i botuar në të përditshmen Utrinski Vesnik më 16.10.2006

gjithashtu të marrin pjesë më aktivisht në procesin e vendim-marrjes (Neni 11/2.3.4.5).

Sipas statutit të partisë, kandidatët për funksione partiake mund të propozohen nga anëtarët e partisë, nëpërmjet vetë-propozimit, si dhe me propozim nga kryetari, sekretari dhe Këshilli Ekzekutiv i partisë (neni 68). Zgjedhja e zyrtarëve të LSDM-së, duke përfshirë edhe kryetarin e partisë, kryhet nëpërmjet votimit të fshehtë, në dy raunde. Në raundin e parë, nevojitet shumica e votave nga të pranishmit, me kusht që numri të përfaqësojë jo më pak se një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të trupit. Dy kandidatë vazhdojnë në raundin e dytë. Për fitore mjafton të sigurohen votat e shumicës relative, e cila duhet të jetë jo më pak se një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të organeve. Sa i përket zgjedhjes së kryetarit të partisë, në praktikë zakonisht vetëm një kandidat propozohet në Kongres, kështu që fitorja e tij është e pakontestueshme. Në vitin 2003, u dëgjua se Tito Petkovski do të kandidohej për postin e kryetarit të partisë, duke sfiduar Branko Červenkovskin. Sipas Petkovskit, kur dy kandidatë garojnë për këtë pozicion, kjo pa mëdyshje kontribuon në forcimin e demokracisë partiake.<sup>21</sup> Që prej formimit të partisë, në pozicionin e kryetarit të LSDM-së kanë qenë Branko Červenkovski (1991-2004), Vllado Buçkovski (2004-2006) dhe Radmilla Shekerinska (2006-2008). Në Kongresin e 9-të në vitin 2009, delegatët e partisë rizgjodhën Branko Červenkovski si kryetar të partisë.<sup>22</sup>

Në VMRO-DPMNE, nominimi i kandidatëve për kryetar partie behet në kongres të partisë, dhe sipas Statutit të partisë, të propozuarit duhet të mbështeten nga të paktën 30 anëtarë të Kongresit (neni 20). Në këtë mënyrë, hapet mundësia për

---

<sup>21</sup> "Červenkovski nuk do të ketë kundër kandidat për pozitën e kryetari" artikull i botuar në gazetën e përditshme "Dnevnik" më 18.03.2006

<sup>22</sup> Burim: Historia e LSDM-së e publikuar në faqen zyrtare të internetit sds.org.mk



propozimin e më shumë se një kandidati. Kështu ishte rasti në vitin 2003, kur Nikolla Gruevski dhe Marjan Gjorçevi u kandiduan për këtë post. Vlen të theksohet, se në praktikë kryetari i partisë dhe Komisioni Qendror mund të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në procesin zgjedhor në mënyrë që të sigurojnë fitoren për kandidatin që ata favorizojnë. Një ndikim i tillë u ushtrua nga ish-kryetari i partisë Lubço Georgievski, i cili mbështeti zgjedhjen e Nikolla Gruevskit si kryetar partie.<sup>23</sup>

Statuti i PLD-së thotë se kandidatët janë të vetë-emëruar dhe Kuvendi i Partisë zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Partisë (neni 34). Në praktikë, zakonisht ka vetëm një kandidat dhe fitorja është e pakontestueshme. Kështu ishte rasti edhe me zgjedhjen e kryetarit aktual të PLD-së, Andrej Zhernovski që zëvendësoi Jovan Manasievskin në këtë pozitë. Manasievski dha dorëheqje nga posti, pas rezultatit të dobët zgjedhor të PLD-së në zgjedhjet parlamentare në vitin 2011.<sup>24</sup>

Propzimi i kandidatëve për kryetar partie në PDSH bëhet nga delegat të Kongresit të Partisë, i mbështetur nga të paktën 10% të delegatëve. Pastaj, procedura kërkon votim të fshehtë nga delegatët e Kongresit, i cili gjithashtu ka fuqinë të shkarkojë Kryetarin (neni 38). Lideri i partisë është ndërruar vetëm një herë kur për shkak të problemeve shëndetësore të liderit të partisë Arben Xhaferi, kryetar u bë Menduh Thaqi.

E njëjta procedurë parashihet edhe me Statutin e BDI-së sipas nenit 44. Megjithatë, Statuti nënkupton se kriteret sipas të cilave një kandidat mund të propozohet janë të përcaktuara nga Komiteti Qendror (neni 45). Megjithatë, duhet theksuar se asnjëherë nuk ka pasur ndërrim të kryetarit që prej formimit

---

<sup>23</sup> "Gjorçevi dhe Gruevski filluan luftën për pozitën e liderit" ; artikulli u botua në gazetën përditshme Dnevnik më 16.10.2006

<sup>24</sup> Burimi: gazeta e përditshme Nova Makedonija, 03.10.2011

të partisë. Ky funksion është ushtruar nga Ali Ahmeti, pozita e të cilit nuk është kontestuar deri tani.<sup>25</sup>

Sipas statutit të RDK-së, zgjedhja e kryetarit bëhet në kongres të partisë (36.6). Trupi i njëjtë i partisë ka të drejtën të votojë për kryetarin e partisë në bazë të nenit 36.7.

- Kush propozon dhe zgjedh nënkryetarin?

Procedurat për propozimin dhe zgjedhjen e nënkryetarit të LSDM është dhënë në nenin 68, i cili gjithashtu rregullon procedurat për zgjedhjen e kryetarit të partisë dhe postet e tjera të organeve qendrore të partisë. Trupi i partisë që luan rol qendror në procesin zgjedhor është Komiteti Qendror që përcakton kriteret për propozim dhe zgjedhje të kandidatëve.

Në VMRO-DPMN kryetari i partisë propozon kandidatë për nënkryetarë të partisë. Sipas nenit 24 të Statutit, për nënkryetarët voton Komiteti Qendror i Partisë. Në mënyrë të ngjashme, propozimi i kandidatëve për nënkryetarë në BDI bëhet nga kryetari i partisë. Asambleja e Përgjithshme e Partisë më pas voton për propozimin (neni 40.4). Megjithatë, duhet të theksohet se neni 44.5 i cili i jep kryetarit të partisë të drejtën e vetos mbi vendimet dhe propozimet e çdo trupi të partisë, ai mund ta përdor atë gjithashtu që të ushtrojë ndikimin e tij në zgjedhjen e nënkryetarëve.

Të drejtën të propozojë kandidatët për nënkryetarë në PDSH kanë edhe kryetari (neni 46) edhe Komiteti Qendror, i cili mund të caktojë një kandidat që e mbështesin së paku 1/3 e anëtarëve të tij (neni 55). Kandidatët e propozuar nga Komiteti Qendror, megjithatë, duhet të miratohen nga kryetari. Nënkryetarët votohen nga Komiteti Qendror dhe i

---

<sup>25</sup> Intervistë me funksionarë të BDI-së e botuar në të përditshmen Dnevnik më, 24.10.2010

njëjti organ (të paktën ¼ e anëtarëve të tij) mund të iniciojnë procedurën për të votuar nënkryetarin. Kryetari ka edhe të drejtën të refuzojë kandidatin për nënkryetar.

Në PLD kandidatët për nënkryetarë emërohen nga kryetari i Partisë, dhe Komiteti Qendror është ai që voton ose refuzon kandidatin (neni 39). Në procesin zgjedhor për nënkryetar, rol vendimtar kanë kryetari dhe Këshilli Ekzekutiv.

E drejta të propozojë kandidatët për nënkryetarë në RDK i është dhënë kryetarit të partisë, ndërsa zgjedhjen e bën Komiteti Qendror (neni 83 dhe 51.2). Organet e njëjta partiake janë të përfshirë dhe ndiqet e njëjta procedure edhe gjatë refuzimit të kandidatit për nënkryetar. Respektivisht, kryetari i partisë i propozon, dhe Komiteti Qendror i pranon ose refuzon kandidatët.

- Kush mundet ligjërisht të votojë ose të refuzojë Sekretarin e Përgjithshëm?

Në LSDM, procedurat për emërim, votim për/kundër të Sekretarit të Përgjithshëm dhe organeve partiake të përfshira në proces është paraparë në Statutin e partisë me nenet 68-74. Procedura është e njëjtë për zyrtarët e partisë, Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët e Këshillit Ekzekutiv. Megjithatë, tre zyrtarët e lartë të partisë janë të detyruar të paraqesin program të detajuar të punës para Këshillit Ekzekutiv. Në PLD, të gjithë anëtarët e partisë të interesuar për postin e Sekretarit të Përgjithshëm mund të vetë propozohen.

Propozimi i kandidatëve për Sekretar të Përgjithshëm në PDSH bëhet nga Komiteti Qendror me propozim të Kryetarit. Komiteti Qendror me Statut ka të drejtën të votojë për ose kundër kandidatit për Sekretar të Përgjithshëm (neni 40.5).

Nuk ka nevojë të përmendim se kryetari ka të drejtën e vetos në të gjitha vendimet dhe propozimet e të gjitha organeve partiake, sipas Nenit 44.5.

Procedura për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm në BDI është përcaktuar në nenet 58, 46 dhe 48. Sipas kësaj procedure, Komiteti i Përgjithshëm propozon kandidatin me mbështetjen e të paktën 1/3 të anëtarëve dhe me propozim të kryetarit të partisë. Pastaj, Komiteti i Përgjithshëm voton përr ose kundër kandidatit për Sekretar të Përgjithshëm.

Propozimet për postin e Sekretarit të Përgjithshëm në RDK i jep kryetari i partisë (neni 83). Më tej Komiteti Qendror voton për Sekretarin e Përgjithshëm, dhe i njëjti trup partiak ka të drejtën të votojë kundër kandidatit për Sekretar të Përgjithshëm (neni 51.3).

- Kush mundet të votojë përr ose kundër zgjedhjes së Këshillit Ekzekutiv?

Sipas Statutit të VMRO-DPMNE-së, Komiteti Qendror voton për ose kundër zgjedhjes së Këshillit Ekzekutiv janë (neni 24). Gjithashtu, nëse kandidati plotëson normat e cilësisë, kryetari mund të përdorë autoritetin e tij për të pranuar ndonjë kandidat të caktuar për anëtar të Këshillit Ekzekutiv. Gjithashtu, Komiteti Qendror i PLD-se voton për ose kundër zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv sipas nenit 39 të Statutit të Partisë. Njësoj si në rastin e mësipërm, kryetari i partisë ka ndikim vendimtar në procesin e votimit të anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv.

Sipas nenit 54 të Statutit të BDI-së, Këshilli Ekzekutiv përgjigjet para Komitetit Qendror. Emërimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Ekzekutiv bëhet nga kryetari i partisë.

Në PDSH, kandidatët e Këshillit Ekzekutiv zgjidhen nga anëtarët e Komitetit Qendror, dhe po ku organ voton për ose kundër anëtarëve të organit ekzekutiv (neni 43.7). Këtu mund të përdoret e drejta absolute e vetos të kryetarit, gjithashtu sipas nenit 44.5.

Këshillin Ekzekutiv të LSDM-së e përbëjnë Kryetari i partisë, Sekretari i partisë, nënkryetarët, sekretari organizativ, sekretari për bashkëpunim ndërkombëtar dhe 17-19 anëtarë të zgjedhur nga anëtarët e Komitetit Qendror. Procedura e zgjedhjes përcaktohet në nenet 68-74 të Statutit të LSDM-së. Në RDK Komiteti Qendror ka të drejtë të votojë për dhe kundër zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Ekzekutiv në bazë të nenit 51.1/10 të statutit të Partisë.

- Niveli i përfaqësimit të partisë

Për demokracinë e brendshme të partisë me rëndësi është të dihet nëse organet partiake marrin parasysh shpërndarjen e mandateve në të gjithë rajonet, gjinitë, moshat dhe statusin social. Kongresi është organi më i madh partiak i VMRO-DPMNE-së dhe kriteret për shpërndarjen e delegatëve i përcakton Komiteti Qendror. Në përgjithësi, të gjitha kriteret e përfaqësimit të përmendura janë përmbledhur në përzgjedhjen e delegatëve. Mbledhjet e rregullta të Kongresit mbahen një herë në katër vjet, por ekziston mundësia të thirret e një mbledhje e jashtëzakonshme.

Komiteti Qendror i partisë ka anëtarë nga të gjitha komitetet rajonale në vend, dhe kështu sigurohet në një farë mase përfaqësimi rajonal. Respektohen përfaqësimi gjinor, i moshave dhe statusit sociale. Komiteti Qendror mban mbledhje sipas nevojës, por të paktën një herë në tre muaj. Komiteti Ekzekutiv i VMRO-DPMNE-së si organi më i vogël

i partisë, me vetëm 17 anëtarë i ka përmbushur të gjitha kriteret e përfaqësimit brenda kufijve të mundësisë. Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv mbahen një herë në javë. Vendimet e miratuara në Kongresin janë të detyrueshme për Komitetin Ekzekutiv.

Në PLD, organi më i madh i partisë - Kuvendi ka një lloj përfaqësimi rajonal pasi ka anëtarë nga të gjitha komitetet komunale dhe komitetit të qytetit (neni 31). Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë në rastin e gjinisë dhe statusit social. Pjesëmarrja e rinisë të partisë sigurohet nga disa delegatë nga Rinia Liberal Demokrate, por përveç kësaj, nuk bëhet asnjë përpjekje më e madhe për të mbajtur ekuilibrin nga aspekti i moshës në këtë trup. Mbledhjet e Kuvendit mbahen sipas nevojës por së paku një herë në dy vjet (Neni 32).

Komiteti Ekzekutiv i PLD-së është një organ mjaft i vogël, kështu që është vështirë të ruhet përfaqësimi rajonal. Bëhen disa përpjekje që të sigurohet përfaqësimi gjinorë dhe në moshë, por kjo nuk vlen për statusin social të anëtarëve të tij. Komiteti Ekzekutiv i mban takimet sipas nevojës.

Komiteti Qendror ruan përfaqësimin gjinor dhe në moshë, dhe pjesërisht atë që ka të bëjë me rajonet, por aspak në lidhje me statusin social. Mbledhjet e komitetit mbahen sipas nevojës (neni 37).

Asambleja e Përgjithshme e PDSH-së, organi më i madh përfaqësues ose partia, thërret mbledhje së paku dy herë në vit (neni 41). Duke pasur parasysh që anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme zgjidhen nga Kongresi i Partisë (neni 39) përfaqësimi gjinor, social dhe gjeografik i këtij trupi është i diskutueshëm.

Si organ përfaqësues, Këshilli i PDSH-së përbëhet nga 9 anëtarë (neni 50), në të cilin nuk është ruajtur përfaqësimi gjinor pasi që vetëm një vend është i rezervuar për gratë. Megjithatë, situata në lidhje me përfaqësimin e grave në Komitetin Qendror është e mirë, ku 6 nga 25 anëtarët janë femra (neni 42).

Në BDI, numri i përfaqësuesve në Kuvend përcaktohet nga Komiteti Qendror në bazë të numrit të anëtarëve në organizatat komunale (neni 42). Kështu, përfaqësimi gjeografik deri diku është i siguar. Kuvendi mbledhet një herë në katër vjet. Për më tepër, Kongresi i partisë mund të thirret sipas nevojës, me propozim të kryetarit ose të 2/3 të anëtarëve të Komitetit Qendror (neni 41).

Bordi Ekzekutiv i partisë përbëhet nga 21 anëtarë dhe mban takime sipas nevojës, por së paku një herë në muaj (neni 52), ndërsa Komitetit Qendror, përbëhet nga 75 anëtarë (neni 47) dhe mbledhet të paktën një herë në gjashtë muaj.

Në LSDM, Kongresi është organi më i lartë i partisë dhe delegatët zgjidhen për një periudhë prej 4 vitesh. Kongresi ruan përfaqësimin gjeografik automatikisht, pasi që delegatët zgjidhen nga organizatat komunale në bazë të përfaqësimit proporcional të numrit të anëtarëve në to (neni 24). Ka edhe tendencat që në Kongres të sigurohet edhe përfaqësimi i barabartë gjinor.

Komiteti Qendror është organi më i lartë i partisë midis dy Kongreseve. Sipas nenit 25, Komiteti Qendror është i përbërë prej 70-90 anëtarë. Përfaqësimi gjinor brenda këtij organi respektohet, duke pasur parasysh se në përbërjen aktuale 25 nga 87 anëtarë janë femra. Sipas nenit 30, mbledhjet e Komitetit Qendror mbahen sipas nevojës, por së paku një herë në çdo tre muaj.

Tabela 1: Indeksi i demokracisë partiake në Maqedoni – niveli i përgjithshëm i demokracisë brenda partisë

	LSDM	VMRO-DPMNE	PLD	BDI	PDSH	RDK	Shpjegim i indeksit (kategoritë mesatare janë poashtu të mundura)
Mundësia për të pasur fraksione në parti	0	0	0.5	0	0	0	Ekziston mundësia ligjore dhe praktike =3 Vetëm mundësi ligjore=2 Në praktikë tolerohen anëtarët e partisë=1 Nuk ka mundësi ligjore dhe praktike=0
Kritika ndaj qëndrimeve të partisë	2	2	2	2	2	2	Ekziston mundësia ligjore dhe praktike =3 Vetëm mundësi ligjore=2 Në praktikë tolerohen anëtarët e partisë=1 Nuk ka mundësi ligjore dhe praktike=0
Votë në kundërshtim me qëndrimet partiake	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	Ekziston mundësia ligjore dhe praktike =3 Vetëm mundësi ligjore=2 Në praktikë tolerohen anëtarët e partisë=1 Nuk ka mundësi ligjore dhe praktike=0
Zgjedhje në postet partiake /shkarkim i kryetarit	2	2	2.5	2	2	2	Të gjithë anëtarët votojnë =3 Voton Kongresi=2 Voton Këshilli I Përgjithshëm = 1 Kontroll nga Kryetari. Kryesia/ organi ekzekutiv=0
Zgjedhje në postet partiake/ shkarkim i nën kryetarit	2	1	0.5	1	0.5	0.5	Të gjithë anëtarët votojnë =3 Voton Kongresi=2 Voton Këshilli I Përgjithshëm = 1 Kontroll nga Kryetari. Kryesia/ organi ekzekutiv=0



Zgjedhje në postet partiake/, Sekretar i përgjithshëm	2	0.5	2	1	0.5	0.5	Të gjithë anëtarët votojnë =3 Voton Kongresi=2 Voton Këshilli I Përgjithshëm = 1 Kontroll nga Kryetari. Kryesia/ organi ekzekutiv=0
Zgjedhje në postet partiake /shkarkim i Këshillit Ekzekutiv	1.5	1	1	0.5	0.5	0.5	Të gjithë anëtarët votojnë =3 Voton Kongresi=2 Voton Këshilli I Përgjithshëm = 1 Kontroll nga Kryetari. Kryesia/ organi ekzekutiv=0
Diversiteti/ përfaqësimi i grupeve minoritare dhe të rrezikuara në organet partiake	2.5	2.5	1	1	1	1	Niveli i lartë i diversitetit (balancë në tri kategori, gjinia, mosha, rajonet)=3 Niveli mesatar i diversitetit (balanca në dy nga kategoritë, gjinia, mosha, rajoni)=2 Niveli i ulët i diversitetit (balanca në një nga kategoritë, gjinia, mosha, rajoni )=1 Nuk ka diversiteti (meshkuj, mosha, të përqendruar në një rajon)=0
GJITHSEJ	12.5	9.5	10	8	7	7	

# 3.

## **MARRËDHËNIET NDËRMJET ORGANEVE QENDRORE TË PARTISË DHE DEGËVE LOKALE**

Nga aspekti i demokracisë brenda partiake, marrëdhëniet midis organeve qendrore të partisë dhe degëve lokale gjithmonë ka qenë një çështjet qendrore. Marrëdhëniet e pushtetit brenda partive të centralizuara vendosen në mënyrë të tillë që siguron dominimin e elitës mbi strukturat e partisë duke pretenduar pronësinë të procesit të vendim-marrjes. Kështu, anëtarët e partisë janë shpesh objekt i diskriminimit dhe përjashtimit nga rrjedhat politike brenda partisë. Sipas dijetarit gjerman Mitchels Robert (1962), tendencat e tilla janë rezultat i përpjekjeve të lidërsipit të partisë për të kontrolluar partinë në dëm të anëtarësisë partiake. Ekskluziviteti brenda partive në demokracitë në zhvillim mund të dëmtojnë në masë të madhe zhvillimin e proceseve demokratike.

Në rastin e Maqedonisë, dominimi i udhëheqësisë është një nga pengesat kryesore për demokracinë partiake dhe rrjedhimisht, zhvillimin e demokracisë në vend. Kjo është evidentuar si në debatin akademik (shih për shembull te Siljanoska-Davkova, 2005) ashtu dhe në gazeta. Më poshtë, rasti i Maqedonisë është shqyrtuar në më shumë detaje.

- Kush ka të drejtë të themelojë degë partiake

Organizimi i VMRO-DPMNE-së në nivel lokal ka katër lloje të ndryshme të organeve: komitetet komunale, komisionet e njësive zgjedhore, komitetet lokale, dhe komisionet përtej kufijve (neni 39).

Komiteti komunal është organi më i lartë në organizimin komunal. Vendimin për formimin e një komisioni komunal, në bazë të Rregullores, e sjell Komiteti Ekzekutiv i VMRO DPMNE-së. Por në praktikë, këtë vendim e sjell Komiteti Qendror. Të drejtën për të shkarkuar Komitetin Komunal nuk e ka asnjë organ në veçanti në Statutin dhe Rregulloren e punës, por në praktikë kjo bëhet edhe nga Komiteti Qendror.

LSDM-ja ka model të decentralizuar të organizimit. Organizimi bëhet mbi parimin territorial, në hierarki dhe subordinim midis niveleve lokale dhe shtetërore (neni 39). Organizatat lokale janë forma themelore të ndërtimit të vullnetit politik dhe realizimit të të drejtave dhe angazhimeve të anëtarëve të partisë. Organet e LSDM-së në nivel lokal janë: Konferenca, kryetari i organizatës komunale, Këshilli Ekzekutiv komunal dhe Këshilli Mbikëqyrës komunal (neni 41). Një organizatë komunale mund të përfshijë disa nën-nivele të organizatave të vendbanimeve. Konferenca është organi më i lartë i organizatës komunale dhe përbëhet nga kryetari, anëtarët e kryesisë dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, por edhe nga anëtarët e Këshillit Komunal, anëtarët e Këshillit Qendror, deputetët, ministrat dhe zëvendësministrat nga organizata komunale përkatëse, dhe kryetarit të i komunës dhe kryetarit të klubit lokal të Rinisë Socialdemokrate të Maqedonisë. Kompetencat e Konferencës janë: propozimi i kandidatëve për organet e LSDM-së, si dhe propozimi i kandidateve për organet e vetëqeverisjes lokale; pjesëmarrja në ndërtimin dhe realizimin e programit të partisë, zgjedhjen e kryetarit të organizatës komunale, anëtarëve të kryesisë dhe Këshillit Mbikëqyrës të organizatës komunale; zgjedhja e delegatëve

për kongresin, shqyrtimi i raportit të organeve të LSDM-së, etj (neni 42). Organizata komunale sipas statutit mund të krijohet ose shpërbëhet nga Këshilli Qendror (Neni 39.3).

Organizimi i Partisë Liberal Demokrate gjithashtu bazohet në një parim territoriale. Organizata komunale është forma bazë e organizimit për qytetarët e një komune. Vendimi për formimin e një organizate komunale sillet nga Komiteti Qendror i partisë. Komiteti Qendror është gjithashtu organi që vendos mbi shkarkimin e organizatës komunale (neni 16 dhe 17).

Vendimin për formimin e organizatës komunale në PDSH e sjell Kuvendi dhe i njëjti organ mund të pezullojë apo shkarkojë organizatat komunale (neni 23.2). Përveç kësaj, nëse së paku 20 anëtarë të partisë kërkojnë formimin e një organizate komunale, Komiteti Qendror mund të sjellë një vendim të tillë (neni 18.3). Në rastet e shkeljeve serioze të Statutit gjatë punës së organizatave komunale, kryetari i partisë mund të propozojë pezullimin ose shkarkimin e saj (neni 44.6).

Sipas Statutit të BDI-së, Komiteti Ekzekutiv vendos për formimin e organizatës komunale, me kërkesën e të paktën 20 anëtarëve të partisë nga rajoni (neni 22). Të drejtën për të shkarkuar organizatën komunale e ka kryetari i partisë, në rast se konsideron se organizimi komunal vepron në kundërshtim me Statutin e partisë (neni 46).

Në RDK vendasit mund të organizojnë një degë në bashkëpunim me Zyrën qendrore e cila voton propozimin.

- Kush harton programin për zgjedhjet lokale?

Procedura e hartimit të programit për zgjedhjet lokale, nuk është e përcaktuar në Statutin e LSDM-së megjithëse do të duhej të jetë. Në praktikë, organizatat komunale hartojnë programin përmes debatit lokal, sugjerime të anëtarësisë dhe komisione të specializuara dhe anëtarë konsulte të LSDM-së dhe e njëjta vendoset në Konferencën e Komunës. Kongresi më pas miraton programin.

Kur bëhet fjalë për hartimin e programit zgjedhor për zgjedhjet lokale në VMRO-DPMNE, në këtë proces përfshihet një ekip i gjerë. Ai përfshin ekipet e ekspertëve nga komisionet komunale, komitetet lokale, këshilltarët nga komunat, ekipe nga Komiteti Ekzekutiv dhe Qendror dhe qytetarët përmes një thirrje publike në media. Këtë program zgjedhor më pas e miraton komiteti qendror.

Në PLD organizata lokale nuk kanë autonomi për të krijuar programin e tyre për zgjedhjet lokale. Këtë e bëjnë organet më të larta në hierarkinë partiake: Komitetit Ekzekutiv dhe kryetari i partisë. Këtë program e miraton Komiteti Qendror i partisë.

Procedura për hartimin e programit zgjedhor në PDSH është rezultat i një praktike të vendosur, dhe jo formalisht e përcaktuar me Statutin e partisë. Aktualisht, formulimi i programit të partisë për zgjedhjet lokale i është besuar një anëtar i partisë i cili ka diplomuar në fushën e opinionit publik dhe të komunikimit masiv. Megjithatë, ai nuk është as anëtar i udhëheqësisë partiake madje as nuk ekziston një post i tillë i përcaktuar me statutin e partisë.<sup>26</sup> Pas hartimit të programit zgjedhor, degët lokale hapin zyrën zgjedhor dhe komisionin zgjedhor.

---

<sup>26</sup> Intervistë me anëtar të PDSH-së

Në BDI, programin është duke e hartuar një komision i posaçëm i formuar nga anëtarë të lartë të partisë, akademikë dhe studiues të tjerë. Ky komision nuk është i paraparë me Statutin e partisë, por është një organ joformal i partisë i cili ka një përbërje që ndryshon varësisht nga rasti. Roli i degëve lokale në krijimin e programit zgjedhor është shumë i kufizuar.<sup>27</sup> Në RDK ende nuk është e qartë se kush do të hartojë programin e partisë për zgjedhjet vendore pasi kjo është hera e parë që partia merr pjesë në zgjedhje të tilla. Pritet se një grup ekspertësh do të hartojë programin pasi të konsultojë degët.<sup>28</sup>

- Kush propozon/miratton kandidatët për kryetarë komune?

Në bazë të nenit 43 të Statutit të LSDM-së, të drejtën të propozojë kandidatët për pozitat në zgjedhjet lokale, duke përfshirë edhe atë për kryetar komune, e ka konferenca komunale. I njëjti nen i Statutit parashikon thirrjen e konferencës të detyrueshme komunale para çdo cikli të zgjedhjeve lokale. Ndërsa rezultatet e zgjedhjeve lokale analizohen në konventë komunale.

Statuti i VMRO-DPMNE-së nuk përcakton procedurën për emërimin dhe përzgjedhje të kandidatëve për pozitat zgjedhore në nivel lokal. Megjithatë, partia përcakton praktikë për përzgjedhjen e kandidatëve. Në të kaluarën, organizata komunale kishte të drejtën të zgjedh kandidatin i cili më vonë miratohet ose refuzohet nga organet partiake qendrore. Kjo praktikë ka ndryshuar kohëve të fundit, kështu që procedura e re përfshin thirrje të hapur publike në të cilat aplikuesit (anëtarë dhe jo anëtarë të partisë) me

---

<sup>27</sup> Intervistë me anëtar të BDI-së

<sup>28</sup> Intervistë me anëtar të RDK-së

vetë nominimi shprehin synimin e tyre për t'u kandiduar për kryetar komune. Aplikacionet shqyrtohen nga një komision i formuar nga Komiteti Qendror. Kandidatët e suksesshëm në këtë proces para përzgjedhjes do të intervistohen nga lideri partiak.<sup>29</sup>

Në PLD, përzgjedhjen e kandidatëve për kryetarë komune, sipas statutit të partisë, e bën organizata komunale (neni 23), por në praktikë këtë e bën udhëheqësia e partisë.

Sipas Statutit të PDSH-së, neni 27 parasheh thirrjen e kuvendit të organizatës komunale për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitat zgjedhore lokale.

Në BDI, sipas nenit 31 të Statutit, organizata komunale e propozon kandidatin për kryetar komune, në përputhje me prioritetet dhe kriteret të përcaktuara nga Komiteti Qendror dhe kryetari i partisë. Komiteti Qendror ka të drejtën të verifikojë listën e kandidatëve për postet në zgjedhjet lokale në të gjitha komunat (neni 48). Në RDK degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë e bëjnë propozimin e kandidatëve.

- Kush i emëron/aprovon kandidatët për listat e këshillit komunal?

Procedura për propozimin dhe miratimin e kandidatëve për Këshillin Komunal dhe për Kryetarin Komunal në LSDM, përcaktohet me nenin 43 të Statutit. Kjo bëhet nga Konferenca e komunës dhe ajo ka autonomi të plotë në renditjen e listës. Në VMRO-DPMNE përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet lokale dhe renditjen e tyre në listat zgjedhore e miraton Komiteti Qendror mbi një propozim nga ana e degëve lokale.

---

<sup>29</sup> Intervistë me anëtar të VMRO-DPMNE-së

Ngjashëm me përzgjedhjen e kandidatëve për kryetarë, në bazë të statutit të PLD-së, kandidatët për zgjedhjet lokale regjistrohen nga organizatat komunale dhe më pas i dorëzohen Komitetit Qendror. Në praktikë, përzgjedhja bëhet nga udhëheqësia e partisë me një konsultim paraprak me menaxhmentin komunal. Udhëheqësia partiake është ajo që përcakton rendin e kandidatëve në listat zgjedhore.

Në PDSH dhe BDI procedurat për propozimin dhe miratimin e kandidatëve për zgjedhjet lokale janë të njëjta si procedurat për kandidatë për kryetarë të komunave të përshkruara në seksionin e mëparshëm. Në RDK, megjithëse ende shqyrtohet, propozimin dhe miratimin e kandidatëve për zgjedhjet lokale duhet ta bëjnë degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë.<sup>30</sup>

- Partnerët e koalicionit në zgjedhjet lokale. Kush vendos?

Sipas nenit 47 të statutit të LSDM-së, Këshilli Ekzekutiv Komunal në konsultim me Këshillin Ekzekutiv Qendror ka të drejtën të marrë vendim për koalicion në nivel lokal. Gjithashtu KEK-u mund të ngre iniciativën për krijimin e koalicioneve lokale sipas nevojës. Në PLD, për këtë çështje vendos udhëheqësia qendrore e partisë. Në VMRO-DPMNE këtë të drejtë e ka Komitetit Qendror.

Statuti i PDSH-së nuk parashikon procedurë të veçantë për këtë çështje dhe vendimi sillet në bazë të nenit 59 i cili thotë se partia mund të hyjë në koalicion me të gjitha partitë demokratike dhe progresive. Në BDI, megjithatë, përzgjedhja e një partie të koalicionit bëhet nga lideri i partisë dhe Komiteti Qendror (nenet 46 dhe 48). Edhe pse çështja nuk është vendosur ende për zgjedhjet në 2013, në RDK degët lokale

---

<sup>30</sup> Intervistë me a anëtar të RDK-së



në konsultim me ekzekutivin e partisë vendosin për zgjedhjen e partnerit për koalicion.

- A është e mundur që anëtarët e degëve lokale të jenë në të njëjtën pozitë në nivel qendror të partisë

Në VMRO-DPMNE, rregullat e partisë lejojnë që anëtarët e degëve lokale të jenë bartës të ndonjë funksioni në parti, por në praktikë këtë të drejtë anëtarët nuk e ushtrojnë shpesh. Në anën tjetër, rregullat e partisë nuk lejojnë që anëtarët e degëve lokale të jenë bartës të funksionit publik, por në praktikë shumë prej tyre janë në të njëjtën kohë drejtorë ose të anëtarë të bordeve këshilluese.

Anëtarët e degëve lokale të PLD-së kanë të drejtë që njëkohësisht të jenë bartës të një funksioni publik dhe ata këtë e bëjnë shpesh. Organizata komunale zgjedh delegatët për Kuvendin e Përgjithshme të PLD-së, kështu që çdo komunë ka përfaqësuesin e vet.

- A mundet degët lokale të propozojnë delegatëve për Konventën/Kongresin dhe Kuvendin e Përgjithshëm të partisë?

Në LSDM, me propozim të një anëtari të Këshillit Ekzekutiv, Konferenca Komunale propozon kandidatët për Konventën Qendrore. Procedura për zgjedhjen e delegatëve lokal për Konventën Qendror përcaktohet me nenin 44.

Organizata komunale zgjedh delegatët për Kuvendin e Përgjithshme të PLD-së, kështu që çdo komunë ka përfaqësuesin e vet.

Në PDSH, Kuvendi i organizatës komunale propozon një listë të kandidatëve për Kongresin e partisë (neni 19.6.5). Me

votim të fshehtë, delegatët në kuvend miratojnë listën. Numri i delegatëve është në proporcion me numrin e anëtarëve të organizatës komunale.

Në rastin e VMRO-DPMNE-se procedura nuk është përshkruar në statutin e partisë, por në praktikë Komiteti Qendror përcakton kriteret për zgjedhjen e delegatëve të Kongresit. Në RDK dega lokale emëron delegatë për Konventën.

Tabela 2: Indeksi i demokracisë në parti – Raportet midis organeve qendrore të partisë dhe degëve lokale

	LSDM	VMRO-DPMNE	PLD	BDI	PDSH	RDK	Shpjegim i indeksit (kategoritë mesatare janë poashtu të mundura)
Kush ka të drejtën të formojë degë të partisë	1	0.5	1	2	1,5	2	Vendasit mund të iniciojnë një degë të re në mënyrë të pavarur nga vendimi qendror =3 Vendasit themelojnë degë në bashkëpunim me zyrën qendrore e cila voton propozimin = 2 Degët lokale I themelon Këshilli i Përgjithshëm =1 Degët lokale themelohen nga zyra ekzekutive e partisë =0
Kush e harton programin për zgjedhjet lokale	2	2.5	0.5	0.5	0.5	0.5	Degët lokale =3 Degët lokale në konsultim me Këshillin e Përgjithshëm =2 Degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë =1 Grup ekzekutiv/ekspert i partisë pa konsultuar degët =0
Kush propozon/miraton kandidatët për kryetar komune?	1	2.5	0.5	2	1.5	1	Degët lokale =3 Degët lokale në konsultim me Këshillin e Përgjithshëm =2 Degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë =1 Grup ekzekutiv/ekspert i partisë pa konsultuar degët =0

Kush propozon /aprovon kandidatët për listat e Këshillit Komunal?	0.5	1.5	1	0.5	1.5	1	Degët lokale =3 Degët lokale në konsultim me Këshillin e Përgjithshëm =2 Degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë =1 Grup ekzekutiv/ekspert i partisë pa konsultuar degët =0
Renditjen e kandidatëve në listat për Këshillin Komunal?	1	1	1	0.5	1.5	1	Degët lokale =3 Degët lokale në konsultim me Këshillin e Përgjithshëm =2 Degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë =1 Grup ekzekutiv/ekspert i partisë pa konsultuar degët =0
Vendimet për partnerë koalicioni në zgjedhjet lokale	0.5	0	0	1	0.5	1	Degët lokale =3 Degët lokale në konsultim me Këshillin e Përgjithshëm =2 Degët lokale në konsultim me ekzekutivin e partisë =1 Grup ekzekutiv/ekspert i partisë pa konsultuar degët =0
A ka mundësi që anëtarët e degëve në nivel lokal të jenë bartës të posteve në nivelin qendror të partisë	1.5	1.5	1	1	1	1	Jo=3 Po, e zgjedh Kongresi =2 Po, e zgjedh Këshilli I Përgjithshëm =1 Po, e zgjedh Zyra ekzekutive e partisë =0
A mundet dega lokale të propozojë delegatë për Konventën dhe Kuvendin e Përgjithshme	2	2	2.5	2.5	2.5	2	Po, vendim I pavarur =3 Po, por me pajtim të Këshillit të Përgjithshëm =2 Po, por me pajtim të Partisë ekzekutive =1 Jo=0
Gjithsej	9.5	11.5	7.5	10	10.5	9.5	

# 4

## ZGJEDHJET DHE DEMOKRACIA BRENDA PARTISË

Ndikim të konsiderueshëm në nivelin e demokracisë së brendshme në një vend ka edhe kuadri ligjor sipas të cilit zhvillohet procesi zgjedhor. Sipas Kodit Zgjedhor<sup>31</sup>, zgjedhja e deputetëve kryhet me sistemin proporcional. Ky sistem konsiderohet të ketë përparësi të shumta mbi sistemit tjetër zgjedhor: numri i të ashtuquajturave „vota të humbura“ është reduktuar në masë të madhe dhe kontribuon shumë në transferimin më të barabartë të votave në mandate, në përfaqësimin më të drejtë të të gjitha segmenteve të shoqërisë, dhe në përfaqësimin më të drejtë gjinor.<sup>32</sup> Megjithatë, në lidhje me demokracinë brenda partisë, në sistemin proporcional, ku lista është e paracaktuar (lista të mbyllura), qytetarët nuk kanë mundësinë të votojnë për kandidatët individualë. Sistem i tillë ndikon pa dyshim në zgjedhjet brenda partisë, duke përcaktuar përfundimisht marrëdhëniet e pushtetit aty.

Së fundi është ringjallur debati mbi demokracinë brenda partiake në Maqedoni nga aspekti i projektit për të futur

<sup>31</sup> Fletushka zyrtare e Republikës së Maqedonisë (Nr.40/2006)

<sup>32</sup> Burim: otverenilisti.org

sistemin e listave të hapura në zgjedhjet parlamentare, që e zbaton shoqata qytetare "Most", Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe Instituti për Demokraci Parlamentare. Nëpërmjet fushatave publike, projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me përparësitë e modelit zgjedhor proporcional me lista të hapura siç janë përgjegjshmëria dhe transparenca më e madhe në procesin zgjedhor.

Argumentet në favor të sistemit me lista të hapura janë se kjo padyshim do të kontribuojë për demokraci më të madhe partiake, duke pasur parasysh se përzgjedhja e kandidatëve do decentralizohet në masë të madhe. Për më tepër, thuhet se ky sistem favorizon kandidatët më të aftë, merr më shumë parasysh preferencat dhe nevojat e qytetarëve dhe kështu që përgjigja e partisë është më efikase (Thessin, 2004, Lehrer, 2012). Më poshtë punimi shqyrton lidhjen midis procesit zgjedhor dhe demokracisë së brendshme në rastin e Maqedonisë, duke u fokusuar në procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet në nivel nacional.

- Kush vendos mbi kandidatët për zgjedhjet parlamentare dhe renditjen e tyre?

Statuti i partisë VMRO-DPMNE nuk e përcakton qartë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, por në praktikën e partisë, kjo funksionon shumë mirë. Përzgjedhjen e kandidatëve për deputet e bën Komiteti Qendror, si dhe renditjen e kandidatëve në listën e kandidatëve. Organizata komunale përfshihet në propozimin e kandidatëve.

Në LSDM, statuti i partisë në mënyrë të qartë përcakton organin që është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet. Komiteti Qendror është ai i cili përcakton kandidatët për zgjedhjet parlamentare dhe renditjen e tyre në

listat zgjedhore (neni 29). Në mënyrë të ngjashme, Komiteti Qendror i PLD-së është edhe organi që është përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet. Kështu, Komiteti Qendror në përputhje me Statutin i përcakton kandidatët për zgjedhjet parlamentare dhe renditjen e tyre në listat zgjedhore (neni 39). Komisioni Qendror i PDSH-së, BDI-së dhe RDK-së respektivisht, është organi partiak që e bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare.

- Kush shkruan/miraton platformat e partive për zgjedhjet nacionale?

Në VMRO-DPMNE, programin zgjedhor e harton një ekip ekspertash dhe qytetarësh, nëpërmjet një njoftimi publik; ekipe nga Komiteti Ekzekutiv, Komitetit Qendror dhe Komitetet Rajonale. Programin zgjedhor më pas miraton Komiteti Qendror.

Sipas Statutit të LSDM-së, Kongresi është organi i partisë që miraton programin e partisë (neni 27,10). Statuti megjithatë, nuk përcakton se cili organ formulon programin e partisë. Programin zgjedhor të PLD-së e hartojnë ekspertë të partisë dhe atë e miraton Komiteti Qendror. Pra, është e qartë se figura qendrore në procesin e zgjedhjeve është Komiteti Qendror.

Tabela 3: Indeksi i demokracisë në parti – Zgjedhjet dhe demokracia partiake

	LSDM	VMRO-DPMNE	PLD	BDI		RDK	Shpjegim i indeksit (kategoritë mesatare janë poashtu të mundura)
Përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhje	2	2	2	2	2	2	Kongresi (Këshilli i Përgjithshëm+degët)=3 Këshilli i Përgjithshëm = 2 Kryesia=1 Kryetari/grup punues në kryesi =0
Renditja e kandidatëve në listat	2	2	2	2	2	2	Kongresi (Këshilli i Përgjithshëm+degët)=3 Këshilli i Përgjithshëm =2 Kryesia=1 Kryetari/grup punues në kryesi =0
Kush harton programin e partisë për zgjedhjet nacionale	2	2.5	2	1.5	1.5	0.5	Kongresi (Këshilli i Përgjithshëm+degët)=3 Këshilli i Përgjithshëm = 2 Kryesia=1 Kryetari/grup punues në kryesi =0
Kush e miraton programin e partisë për zgjedhjet nacionale	2.5	2	1.5	2	2	1.5	Kongresi (Këshilli i Përgjithshëm+degët)=3 Këshilli i Përgjithshëm = 2 Kryesia=1 Kryetari/grup punues në kryesi =0
GJITHËSEJ	8.5	8.5	7.5	7.5	7.5		

# 5. | KONKLuzion

Qëllimi i analizës ishte të vlerësohet demokracia brenda-partiake në Maqedoni duke u fokusuar në elementet thelbësore të demokracisë instrumentale brenda-partiake e organizuar në tri kategori: niveli i përgjithshëm i demokracisë brenda-partiake, autonomia e degëve lokale dhe të demokracia dhe zgjedhjet.

Në debatin akademik, çështja e demokracisë së brendshme në konsolidimin e demokracisë, dhe në Maqedoni, analizohet kryesisht në kontekst të zhvillimit të proceseve demokratike të përgjithshme në këto vende. Me fjalë të tjera, pyetja është se deri në çfarë mase demokracia partiake mund të kontribuojë në zhvillimin e procesit demokratik në tërësi në demokracitë në zhvillim. Megjithatë, nuk është përcaktuar asnjë lidhje e qartë në mes demokracisë në një vend dhe demokracisë brenda partiake. Kështu, për disa dijetarë, në



shtetet demokratike partitë politike duhet doemos të ofrojnë mundësi të barabarta për çdo qytetar që në mënyrë efektive të marrin pjesë në jetën politike. Nga ana tjetër, Hirschman (1972) ka thënë se partitë politike janë organizata vullnetare të cilat janë të lira të vendosin rregullat dhe normat mbi të cilat do të veprojnë. Kështu, anëtarët mund të zgjedhin nëse do të respektojnë këto rregulla dhe norma, ose do të largohen nga partia (Rahat, Hazan dhe Katz, 2008).

Partitë politike në Maqedoni në përgjithësi, identifikohen kryesisht përmes udhëheqësve të tyre që është rezultat i një shpërndarje të centralizuar të pushtetit brenda partive. Prandaj, mund të thuhet se udhëheqësit e partive në Maqedoni posedojnë fuqi të madhe e cila në shumicën e rasteve është e pakontestueshme dhe mund të ushtrohet në forma të ndryshme për të ndikuar në politikën partiake dhe procesin e vendimmarrjes (Siljanoska-Davkova, 2005; Karasimeonov 2005). Vendimet brenda partive sillen në bazë të qasjes nga lartë-poshtë duke penguar kështu shqyrtimin e gjerë në mesin e anëtarëve. Për më tepër, tendencat autokratike të udhëheqësve janë vendosur fuqimisht në praktikën dhe funksionimin e përditshëm të partive politike dhe kjo është pjesë e kulturës partiake në Maqedoni.

Sa për mundësinë e formimit të fraksioneve partiake, asnjë parti në Maqedoni nuk i ka legalizuar në mënyrë normative fraksionet partiake në Statut. Në shumicën e rasteve, fraksionet e partisë nuk përmenden qartë në Statuset e partive. Në praktikë, edhe pse ka një mos toleranca të përgjithshme ndaj fraksioneve partiake, ato ekzistojnë në mënyrë joformale brenda organizatës partiake. Duhet të theksohet megjithatë, se në shumicën e rasteve, fraksionet formohen si rezultat i mosmarrëveshjeve personale mes liderit të partisë dhe anëtarëve të partisë, apo pakënaqësisë të një

grupi të anëtarëve të partisë me disa vendime të lidershipit të partisë, më së shumti në lidhje me çështjet operacionale dhe propomet e anëtarëve të partisë për postet publike. Mosmarrëveshjet serioze mes anëtarit të partisë dhe shumicës në parti pothuajse gjithmonë rezultojnë në marginalizimin nga procesi i vendimmarrjes në parti. Nëse anëtari i partisë gëzon mbështetjen e një grupi me ndikim brenda partisë dhe të qytetarëve, shpeshherë ai / ajo zgjedh të formojë parti të re, për të arritur qëllimet e veta.

Anëtarët e partisë që janë deputet janë të disiplinuar, dhe pothuajse gjithmonë votojnë në përputhje me sugjerimet e organeve partiake qendrore. Për më tepër, deputetët rrallë shprehin ndonjë qëndrim që ndryshon nga politika e miratuar e partisë. Në disa parti, Statuti lejon kritikën, por në praktikë, kritikuesit janë gjithmonë të marginalizuar ose në disa raste, madje edhe përjashtohen nga partia. Nga rezultatet e arritura në indeksin e demokracisë së përgjithshme partiake, RDK-ja qëndron mbrapa në krahasim me partitë e tjera të përfshira në analizë.

Në të gjitha partitë në Maqedoni është detektuar dominim i elitave dhe përqendrimi i pushtetit të madh te liderët e partive të përfshira në analizë. Sa i përket degëve lokale, pavarësisht nga të drejtat e shumta që i kanë degët lokale sipas Statutit, ndikimi i udhëheqjes së partisë është vendimtar në krijimin e politikave dhe vendim marrjen për çështjet operacionale. LSDM-ja, sipas indeksit është partia më e decentralizuar, ku më shumë të drejta u janë dhënë degëve lokale me statut.

Tabela 4: Përmbledhje e indeksit të demokracisë në parti

	LSDA	VMRO-DPMNE	PLD	BDI	PDSH	RDK
Niveli i përgjithshëm i demokracisë brenda partisë	12.5	9.5	10	8	7	6.5
Raporti midis organeve qendrore të partisë dhe degëve lokale	9.5	11.5	7.5	10	10.5	9.5
Zgjedhjet dhe demokracia partiake	8.5	8.5	7.5	7.5	7.5	
GJITHSEJ (Maksimum 60 pikë)	30.5	30.5	25	25.5	25	

Sipas tabelës së mësipërme, partitë politike maqedonase në përgjithësi kanë arritur rreth gjysmën e pikëve maksimale për demokracinë brenda partisë. Në nivelin e kategorisë së demokracisë së përgjithshme brenda partisë, të gjitha partitë kanë shënuar rezultate të ulëta të cilat pa mëdyshje konfirmojnë nivelin e lartë të centralizimit të partive politike. Centralizimi në anën tjetër, mund të çojë në tjetërsimin e mëtejshëm të partive nga zgjedhësit e tyre. Sa i përket kategorisë së dytë, relacionet mes organeve qendrore të partisë dhe organeve lokale, LSDM dhe VMRO-DPMNE kanë shënuar relativisht më shumë pikë se partitë e tjera.

Partitë e tjera mbesin prapa në këtë kategori, kryesisht edhe për shkak të procedurave të tyre në lidhje me procesin e vendimmarrjes në parti, e cila në masë të madhe është në pronësi të organeve partiake qendrore. Kështu, është e qartë se degët lokale kanë nevojë për autonomi më të madhe në hartimin e programeve zgjedhore lokale, emërimin e kandidatëve për zgjedhjet lokale dhe renditjen në lista. Në kategorinë e tretë, zgjedhjet dhe demokracia partiake, të gjithë partitë kanë shënuar më pak pikë që nënkupton se partitë e përfshira në analizë veprojnë më tepër si organizata të centralizuara gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare.

## **Referenca:**

Biezen, Ingrid van (2003): *partitë politike në demokracitë e reja: Organizimi partiak në Evropën Jugore dhe Lindore-Qendrore*, Palgrave Macmillan, Londër.

Duverger, M. (1964) *Partitë politike: Organizimi dhe veprimi i tyre në shtetet moderne*. Londër: Methuen

William Cross dhe André Blais: *Kush përzgjedh liderin e partisë? Party Politics 2012* ,Vol. 18, N.2.

Čular, G.(2004), *Zhvillimi organizativ i partive politike, Politička misao*, Vol. XLI, , Nr. 5, fq. 28–51.

Georgi Karasimeonov, (2005) *Strukturat organizative dhe demokracia brenda partiake në Evropën Jug Lindore*, Sofie: Friedrich Ebert Stiftung

Katz, Richard S./ Mair, Peter (2002): *Ngritja e partisë në postin publik: Ndryshime organizative të partisë ne demokracitë e shekullit njëzet*, në: Gunther, Richard/ Montero

Maiyo Josh (2008), *Partitë politike dhe demokracia brenda partiake në Afrikën Lindore* (MPhil Tesis), University of Leiden: Leiden

Ron Lehrer (2012): *Demokracia brenda partiake dhe përgjegjësia e partisë*, West European Politics, 35:6, 1295-1319

Thessin, Jonathan. J (2007): *Rinovimi i demokracisë brenda partiake: Vlerësimi i konkurrencës, vendimmarrjes dhe të drejtat e shoqërimit të partive* [http://works.bepress.com/jonathan\\_thessin/3](http://works.bepress.com/jonathan_thessin/3)

Sartori, Giovanni (1976): *Partitë dhe sistemet partiake: Kornizë për analizë*, vol. 1. Cambridge: Cambridge University Press.

Scarrow Susan, PhD (2005): *Zbatimi i demokracisë brenda partiake*, NDI: Uashington D.C

Maravall, Jose Maria (2003): *Pasojat politike nga demokracia brenda partiake*, Estudio Working Papers.

National Democratic Institute Guidebook (2008): *Standardet minimale për funksionim demokratik të partive politike*, Uashington

Instituti Holandez për Demokraci Shumëpartiak (2004) *Doracak i zhvillimit institucional: Kornizë për ndërtimin e partive demokratike*. Hagë: NIMD

Gideon Rahat, Reuven Y. Hazan dhe Richard S. Katz (2008), "Mbi raportin e vështirë midis pjesëmarrjes, konkurrencës dhe demokracisë përfaqësuese dhe partive politike," *Party Politics*, Vol. 14, N.6.

Crutzen, B. Castanheira, M. Sahuguet, N. (2009): *Organizimi partiak dhe garimi zgjedhor*, The Journal of Law, Economics, & Organization, Vol. 26, No. 2,

Françoise Boucek, Rimendimi i fraksionizmit (2009) : Tipologjitë, dinamika brenda partiake dhe tri fytyrat e fraksionizmit *Party Politics* vol. 15: N.4.

Peter Burnell dhe Andre Gerrits, (2010). "*Promovimi i partive politike në demokracitë e reja*", Democratization, Vol. 17, No. 6.

Reuven Y. Hazan dhe Gideon Rahat (2010): *Demokracia brenda partive: Metodatat e përzgjedhjes së kandidatëve dhe pasojat e tyre politike*, Oxford Scholarship Online

Daskalovski, Z. et al. (2012): *Analiza e Demokracisë brenda partiave në Kosovë*, Qendra për kërkime dhe politik bërje, Shkup





Konrad  
Adenauer  
Stiftung



**CRPM**

Center for  
Research and  
Policy  
Making

## Fondacioni Konrad Adenauer Zyra në Maqedoni

rr. "Maksim Gorki" 16 / kati i 3  
MK - Shkup  
Republika e Maqedonisë

Telefon: +389 2 323-1122  
Faks: +389 2 313-5290  
Skopje@kas.de  
[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)

[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)  
[www.crpm.org.mk](http://www.crpm.org.mk)